V E N D I M
Nr.432, datë 14.8.1995

PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ZONËN URBANE TË FSHATIT

Në mbështetje të paragrafit të fundit të nenit 21 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimëtarive private të pavarura dhe privatizimit" e të nenit 24 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në zonën urbane të fshatit, komuna ose bashkia i kërkon pronarit dokumente të pronësisë sipas kritereve të përcaktuara në ligj, për pronësinë e ndërtesave dhe të trojeve në këtë zonë.
2. Madhësia e sipërfaqes së truallit në pronësi të pronarit të ndërtesës që ka kryer ndërtimin mbetet ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr.7633, datë 7.4.1993 "Për urbanistikën".
3. Dokumentacioni i azhornimit për pasuritë e paluajtshme të zonës urbane të fshatit sipas formularit që i bashkëngjitet këtij vendimi, vihet në dispozicion të komunës, miratohet nga ky organ dhe bëhet regjistrimi i kësaj pasurie.
4. Ngarkohen organet e pushtetit lokal (komuna dhe bashkia) dhe Njësia e Manaxhimit të Projektit të SRPP për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Rrethi _____
Zona kadastrale nr._____ Emri _____

Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive

Nr	Numri i psurisë	Lloji i Padurisë	Sipërfaqja e truallit m2	Nga sip.truall sa ndërtesë	Emri, atësia, mbiemri	Nënshkrimi

Kryeplaku Miratohet
Kryetari i Komunës